



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 43, datë 08.02.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj dhe Sami Ujkashi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës; të pandehur: {...}; Objekti: “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” dhe “kultivimin i bimëve narkotike” të parashikuar nga nenet 278/7 dhe 284/2 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Maksim Qirjazi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...} Akuza: “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe të municionit”, parashikuar nga neni 76, 22 e 278/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur {...}; Akuza: “Neni 130/a/4 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Desart Avdulaj si dhe gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Pushim i çështjes”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Desart Avdulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...} etj.; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari Fuat Vjerdha”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; Objekti: “Pushimin e procedimit penal nr. 8, datë 11.01.2020, per veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”; Person nën hetim: {...}; Viktima: {...}; Trashëgimtarët e viktimës: {...}, {...}

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Miranda Andoni si dhe gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat; {...}; Objekti: “Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. 434, të vitit 2019, të regjistruar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

3. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}, {...}; Të paditur; {...}, “2AL”; Person i tretë {...}; Objekti: “Përrjashtim nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv, etj.”

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 186/1 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR